

Sistemi i Transferit Automatik / Shlyerja Bruto në Kohë Reale/ Kleringu Automatik (ATS / RTGS / ACH)

I Dashur Guvernator, zëvendësguvernator, zonja dhe zotërinj,

Sot jemi mbledhur këtu për të festuar zbatimin e suksesshëm të një projekti shumë të rëndësishëm për sektorin bankar në Kosovë. Me ndihmën e Bankës Botërore nëpërmjet Projektit Stabiliteti i Sektorit Financiar dhe Infrastrukturës së Tregut (FSSMIP), Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka filluar zbatimin e asaj që përbën një zhvillimi të rëndësishëm – sistemin e transferit automatik (ATS). ATS do të integrojë dhe përmirësojë shpejtësinë, besueshmërinë dhe sigurinë e përpunimit për të dyja llojet e pagesave, me vlerë të lartë dhe me vlerë të ulët nga të gjitha bankat komerciale dhe gjithashtu pagesat nga disa institucione qeveritare siç janë Thesari dhe Doganat.

Nga perspektiva e bankave komerciale në Kosovë, kjo iniciativë është parë si një projekt i një rëndësie të madhe dhe bankat janë plotësisht të angazhuar dhe të përkushtuar që nga fillimi disa vite më parë. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e punës ndërmjet Bankës Qendrore dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës ka qenë i shkëlqyer.

Një numër i madh i ekspertëve dhe profesionistëve të përkushtuar nga BQK-ja, nga të gjitha bankat dhe institucionet si Banka Botërore kanë punuar në këtë projekt për vite me radhe për të ardhur sot në këtë pikë ku mund të shpallim me krenari zbatimin e suksesshëm të projektit dhe arritjen e qëllimeve të tij.

Edhe pse sistemi i mëparshme Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) ka qenë një sistem i cili i ka shërbyer mirë sektorit bankar në Kosovë gjatë 13 viteve të fundit, Sistemi i ri i Transferit Automatik (ATS) është i njohur ndërkombëtarisht dhe i përdorur gjerësisht në botën e bankingut dhe është e rëndësishme që Kosova miraton praktikën dhe parimet që janë në përputhje me praktikën më të mira të vendeve të BE-së dhe institucioneve ndërkombëtare.

Përfitimet që ky sistem do të sjellë në sektorin bankar të Kosovës do të jenë të shumëfishta, duke përfshirë:

- * Është në përputhje me standardet ndërkombëtare bankare në mbarë botën.
- * Formatet e mesazheve janë të standardizuara dhe zbutin rreziqet nga sistemet e pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes.

- * Përshpejton shkëmbimin dhe shlyerjen e fondeve me anë të një procesi përpunimi drejt për drejt të automatizuar.
- * Leverdi më e madhe, shpejtësi dhe siguri për konsumatorët dhe bankat komerciale.
- * Ul kostot operative të sistemit të Kliringut të Bankës Qendrore
- * Integrimi i mëtejshëm i kërkesave të përpunimit në Zonën e Procesimit vetëm për Euro (SEPA)

* Rënie të mundshëm në ndonjë ngarkese mbi transaksion për klientët bankare
Duke pasur parasysh të gjitha këto përfitime, zbatimi i këtij sistemi shënon një tjetër arritje të madhe për sektorin bankar të Kosovës dhe ofron efikasitet më të lartë dhe shpejtësi për klientët tanë si dhe qasje të mëtejshme dhe integrim në arenën ndërkombëtare financiare.

Unë do të doja të përfundojë duke falënderuar disa nga pjesëmarrësit kryesorë në këtë iniciativë, pa të cilit ne nuk do të festonim këtë fillim të suksesshëm sot.

Në mënyrë të veçantë do të doja të falënderoj z.Lulzim Ismajli, Zëvendës Guvernatori i BQK-së, znj Gjylfidane Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të Sistemit të Pagesave dhe ekipin e saj, si dhe këshilltarin e projektit të BQK-së z Abibit Gaye.

Do të doja të falënderoja gjithashtu edhe Bankën Botërore për mbështetjen e tyre të vazhdueshme gjatë gjithë projektit FSSMIP dhe në fund, një faleminderit të singertë për Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe në veçanti anëtarëve të komitetit të pagesave me përfaqësuesit e saj nga bankat komerciale të Kosovës, të cilët shpenzuar shumë kohë, angazhim dhe përpjekje për të ardhur në këtë pikë historike që ne po festojmë sot.

Kjo ngjarje shënon edhe një tjetër zhvillim pozitiv për sektorin bankar për të cilin Kosova mund të jetë me të vërtetë krenare.

Faleminderit.